

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Maj 2023

Tiranë, më 26 Qershor 2023: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Maj 2023, janë 1.230.165. Ky tregues rezulton me një rritje 14,5 %, krahasuar me Maj 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Maj 2023, janë 1.120.387, duke shënuar një rënie me 0,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet e shtetasve

Në Maj 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 525.086. Ky numër është rritur me 11,6 %, krahasuar me Maj 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 705.079. Ky numër është rritur me 16,7 %, krahasuar me Maj 2022.

Gjatë pesëmuajorit të parë 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 2.389.899. Ky numër është rritur me 42,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Maj 2022- Maj 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 26/06/2023

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Maj 2023 janë 490.041. Krahasuar me Maj 2022, ky tregues ka rënë me 5,3 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Maj 2023, janë 630.346. Krahasuar me Maj 2022, ky tregues është rritur me 4,4 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë pesëmuajorit të parë 2023, është 2.447.719, duke u rritur me 21,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Maj 2022	Janar-Maj 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	1.074.828	1.230.165	14,5	3.453.726	4.767.235	38,0
Shqiptarë	470.398	525.086	11,6	1.776.035	2.377.336	33,9
Të huaj	604.430	705.079	16,7	1.677.691	2.389.899	42,5
Dalje gjithsej	1.121.298	1.120.387	-0,1	3.746.141	4.757.923	27,0
Shqiptarë	517.692	490.041	-5,3	2.020.677	2.447.719	21,1
Të huaj	603.606	630.346	4,4	1.725.464	2.310.204	33,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Maj 2023, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 673.706 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore dhe Paqësori, përkatësisht me 19.068 dhe 5.293 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Maj 2022	Maj 2023	Janar - Maj 2022	Janar - Maj 2023
Gjithsej	604.430	705.079	1.677.691	2.389.899
I. Afrika	314	1.935	940	4.213
II. Amerika	15.167	19.068	39.375	55.333
III. Azia Lindore dhe Paqësori	2.216	5.293	6.115	15.060
IV. Lindja e Mesme	2.751	2.049	4.568	5.003
V. Azia e Jugut	1.041	1.345	2.549	4.478
VI. Evropa	551.784	673.706	1.586.943	2.300.558
- Evropa Qëndrore / Lindore	25.917	35.908	58.400	85.771
- Evropa Veriore	20.781	26.864	61.774	76.900
- Evropa Jugore	446.455	521.550	1.322.885	1.920.014
- Evropa Perëndimore	47.987	73.287	114.302	159.966
- Evropa Lindore / Mesdheut	10.644	16.097	29.582	57.907
VII. Rajone të paspecifikuara	31.157	1.683	37.201	5.254

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Maj 2023, krahasuar me Maj 2022, hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur:

- për qëllime personale me 16,6 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 12,8 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 20,3 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Maj 2022	Janar - Maj 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	604.430	705.079	16,7	1.677.691	2.389.899	42,5
I. Personale	593.820	692.313	16,6	1.634.146	2.339.038	43,1
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	568.041	640.717	12,8	1.559.409	2.206.851	41,5
2. Trajtime shëndetësorë	41	155	278,0	458	350	-23,6
3. Qëllime fetare	23	33	43,5	175	156	-10,9
4. Udhëtarë transit	25.715	51.408	99,9	74.104	131.681	77,7
II. Biznes dhe profesionale	10.610	12.766	20,3	43.545	50.861	16,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.